

EFEMERITETI I NJËSIVE TË LIGJËRIMIT STUDENTOR EPHEMERALITY OF UNITS OF STUDENTS' DISCOURSE

ARDIAN DOKA

Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI

ardi_durrsaku@yahoo.com

AKTET VI, 5: 481-485, 2013

PËRMBLEDHJE

Ligjërimi studentor karakterizohet nga një ndryshim i shpejtë i fondit të vet leksikor. Për më tepër, edhe prej bartësve të tij ai perceptohet si një *fluks i vazhdueshëm*, si një prodhues mjetesh komunikimi që shfaqen në çastin e duhur e që janë të paracaktuara për t'u përdorur brenda një kohe të shkurtër. Për ata që vijnë më pas pjesa më e madhe e këtyre fjalëve nuk bie plotësisht në harresë, por, gjithsesi, ato (fjalët) ndihen si të vjetëruara. Nga ky 'rregull' duket se bëjnë përjashtim ato që unë i quajta *lema konstante*, mbi të cilat një 'dënim' i kësaj natyre rëndon më pak. Kjo të shtyn të mendosh se ndryshimi nuk e prek të gjithë fondin leksikor të ligjërit studentor (e aq më pak në të njëjtën kohë), por prek në mënyrë të veçantë anën e tij më të dukshme, *lema flamur*. Disa nga këto fjalë përthithen nga gjuha e zakonshme, madje ato më fatlumet mund të leksikalizohen deri në atë shkallë sa ta bëjnë "të detyrueshme" edhe përfshirjen nëpër fjalorë normativë, siç ka ndodhur fjala vjen me 14 njësi të ligjërimeve rinore të italishtes që janë përfshirë te *Zingareli* (1984) (Holtus: 123).

Fjalët çelës: efemeritei, ligjërimi studentor, lema flamur, lema virtual, lema konstante

HYRJE

Megjithatë duhet pranuar se ligjërimi studentor, njësoj si ligjërimet e tjera rinore, ndryshon shumë më shpejt se gjuha e zakonshme. Fjalë ose shprehje 'të prodhuara' e të përdorura për ca kohë edhe nga i njëjti brez të rinjsh mund të konsiderohen prej tyre si të papërshtatshme, ndonëse mbeten të kuptueshme. Mes njërive të ligjërit studentor ka syresh që jetojnë shumë më pak se të tjerat. Madje, mund të thuhet se ato mbahen si të tilla, d.m.th. si njësi të këtij entiteti, vetëm për hir të faktit se shfaqen aty dhe jo sepse janë vërtet 'pronë' e tij. E kam fjalën për *lema virtuale*, të cilat i zura ngoje edhe më parë (shih më lart në paragrafin 1).

I. Virtualiteti leksikor

Kur trajton çështjen e *virtualitetit leksikor*, Kristof Shvarce propozon një ndarje që më duket mjaft

interesante. Ai bën dallimin mes leksikut si *memorie* dhe si *virtualitet* (Scwarze: 72 – 81). Ndonëse në rastin e ligjërit studentor nuk kemi të bëjmë me një korpus të dokumentuar nëpër fjalorë, si ai që ka parasysh Shvarce, dhe njësitë e tij duket se janë që të gjitha efemere, prapë se prapë kemi një fond leksikor mbi elementet e të cilit rëndojnë po ato pyetje: a i përket 'fjalorit të memorizuar'? Mos kemi të bëjmë me një njësi të 'memorizuar', por në rrugën e daljes nga përdorimi? Është një fjalë thjesht virtuale e përdorur rastësisht, apo është një njësi virtuale që rreket të futet në 'fjalorin e memorizuar'?

Ndarja e leksikut në *memorie* dhe *virtualitet* e nxjerr tezën e efemeritetit të njërive nga qerthulli i konstatimeve empirike duke i dhënë njëfarë mbështetjeje teorike. Nga ana tjetër, ajo ofron edhe një mundësi shpjegimi për vetë dukurinë. Fondi leksikor i ligjërit studentor është efemer,

a ca më keq akoma, virtual, sepse edhe fondi leksikor i asaj që ne kuptojmë me 'gjuhë' qenka pjesërisht i tillë. Kjo e fut një 'sajesë të çuditshme' si ligjërimi studentor brenda hullive të normales.

Ekzistenca e tri shtresimeve në ligjërimin studentor (*lemat konstante*, *lemat flamur* dhe *lemat virtuale*) të cilat nxjerrin në pah edhe efemeritetin, kushtëzohet nga faktorë objektivë e subjektivë. E llojit të parë është nevoja që ndiejnë përdoruesit e tij për t'i braktisur a rikuptimësuar njësitë që e kanë humbur referentin. Llojit të dytë i takon qëndrimi i bartësve të këtij entiteti ndaj njërive që gjallojnë ose krijohen në të; varësisht prej këtij qëndrimi disa syresh gjykohen si të përshtatshme, si të denja për t'i përfaqësuar folësit, e disa jo. Një qëndrim itillë, afërmendësh, shfaqet më qartë në rastin e *lemave flamur*.

II. Lemat virtuale

Tash, jo pse dua t'i vesh me zor ligjërimin studentor kostumin e prerë për tjetërkënd, por për të parë nëse ai me të vërtetë i bindet edhe në këtë pikë asaj logjike që e pajton me 'gjuhën', do të provoj t'i përjas të dyja klasifikimet. Duket se *lemat virtuale* e gjejnë menjëherë vendin e vet në kategorinë e 'fjalëve virtuale', të përdorura rastësisht. 'Fjalori i memorizuar' mund t'i nxinte *lemat konstante*; e po ashtu nuk është e vështirë të vihet shenja e përafritimit (~) mes *lemave flamur* dhe 'njësive virtuale' që përpiqen të futen në 'fjalorin e memorizuar'. Me gjithë përputhjen formale, çështja nuk është kaq e thjeshtë. Shvarce thotë se «fjalët e përdorura me një frekuencë relativisht të lartë i përkasin pa tjetër fjalorit të memorizuar» (Swarze: 75).

E kjo krijon disa probleme.

Së pari, ai si kriterin e vetëm të klasifikimit ka frekuencën e përdorimit të fjalës, kurse në rastin e ligjërimin studentor kriteret bazë janë jetëgjatësia e njësive dhe atributet që u veshin atyre përdoruesit. Natyrisht, edhe frekuenca e përdorimit ka peshën e saj, sepse ndikon në përcaktimin e *lemave flamur*, por, gjithsesi, ajo nuk mund të jetë kriteri kryesor dhe aq më pak i vetmi.

Së dyti, nëse frekuenca e përdorimit për korpuset e dokumentuara është një madhësi e matshme, për njësitë e ligjërimin studentor ajo është vetëm një madhësi e hamendësueshme, me të cilën spekulohet shpesh. Diçka e ngjashme mund të thuhet edhe për jetëgjatëgjatësinë e njësive, por këtu gjërat janë pak më të qarta, sepse në qoftë se një njësi e dhënë ka kaluar nga një brez studentësh te tjetri, ajo fiton të drejtën për t'u quajtur *lemë konstante*.

Së treti, një problem që e ka ngritur edhe vetë Shvarce (Swarze: 75), sa e madhe duhet të jetë frekuenca e përdorimit që një njësi e caktuar të mund të konsiderohet pjesë e 'fjalorit të memorizuar'? Edhe në rastet kur kemi të dhëna të sakta mbi dendurinë e përdorimit, vënia e cilitdo kufi (duke përjashtuar zeron) do të përbente në vetvete diçka arbitrare. Po të prananim, siç është më e udhës, që *lemat flamur* kanë frekuencën më të madhe të përdorimit, atëherë ato do të ishin të parat që do të futeshin me plot të drejtë në 'fjalorin e memorizuar' të ligjërimin studentor.

Pas tyre, për hir të dendurisë më të vogël në përdorim, do të vinin *lemat konstante*, të cilat, e kjo nuk duhet harruar, kanë një përparësi tjetër. Është një fakt i pamohueshëm që përdoruesve u duhet njëfarë kohe për t'u familjarizuar me njësitë para se t'i memorizojnë ato. Këtë e ka vënë re edhe Shvarce që thotë se «nevojiten eksperimente psikolinguistike që do të vendosnin në një raport, fjala vjen vlerat e përdorimit me kohën e nevojshme për njohjen ëe njësiveç nga ana e subjekteve folëse» (Swarze: 76). Kur një njësi e ligjërimin studentor ka një frekuencë shumë të vogël përdorimi, atëherë jemi përballë kësaj alternative: a) është një *lemë flamur* a *konstante* që po del nga përdorimi; b) kemi të bëjmë me një njësi të re që sapo ka hyrë në qarkullim.

III. Këmbimi gjuhësor

Siç shihet, pavarësisht nga problemet që ia relativizojnë jo pak vlerën, jemi të shtrënguar ta shtiem në punë kriterin e dendurisë së përdorimit të njësive. Megjithatë, e rëndësishme është se veçoritë e efemeritetit që e karakterizon nuk e

pengojnë ligjërimin studentor të futet brenda asaj hullie që zura ngoje më sipër.

Ajo që ndodh gjatë këtij procesi (ri)shenjimi të qëllimshëm, shumë më intensiv se ai që vërehet në variantet e tjera të repertorit, e afron ndryshimin në ligjërimin studentor më shumë me atë aspekt të dukurisë që njihet si *këmbimi gjuhësor*. E kjo pikërisht pse ndryshimi në këtë entitet nuk është i rastit.

Ai ka karakter evolutiv në kuptimin që synon përsosjen e entitetit në fjalë (le të kujtojmë atë që unë e quajta *funksioni vetëkorrigjues*) e, ç'është më e rëndësishmja, në të shumtën e herës ai nuk buron së brendshmi, por i imponohet ligjërimin studentor nga 'jashtë', nëpërmjet *lemave flamur* nga trupa e studentëve që kërkon të identifikohet. Nga kjo pikëpamje *lemat flamur* duhen çmuar si një lloj 'norme' e ligjërimin studentor. Në të vërtetë, studentët nuk organizojnë kongrese për ta sanksionuar 'normën' e tyre. Për shkak të heterogjenitetit që i karakterizon *peer group*-et ku bëjnë pjesë, është e vështirë që ata të mendohen si një *folës-dëgjues kolektiv ideal* që emeton e konsumon njësi, i aftë që të marrë vendime të detyrueshme për të gjithë. I vetmi mjet efikas për arritjen e këtij qëllimi është hedhja në qarkullim e *lemave të reja*, duke pritur që ato të shndërrohen në *lema flamur*, falë prirjes për ta ndjekur edhe *modën gjuhësore*.

Fati i *lemave të reja* varet sa nga cilësia e tyre, d.m.th në janë të afta të bëjnë përshtypje ose jo, po aq edhe nga shkalla e kohezionit mes pjesëtarëve të një mikrogrupi e mes vetë mikrogrupeve. Nëse frekuenca e përdorimit të disa prej *lemave të reja* rritet, ky është një tregues që dëshmon se ato po shndërrohen në *lema flamur*, në rast të kundërt mbeten thjesht *lema virtuale* dhe shumë shpejt bien në harresë.

IV. Konsumi dhe konsumizmi gjuhësor

Prania e një 'norme' në ligjërimin studentor ndikon që njësitë e gjetura në të t'i nënshtrohen një prove të vështirë. Ajo ka të bëjë me faktin se ato mund të çmohen si të papërshtatshme, jo vetëm ngaqë janë 'të vjetra', por edhe sepse janë 'të tyret' e jo 'tonat'. Diçka e tillë të shtyn të

mendosh për një lloj gare brenda llojit. E kam fjalën për prirjen e studentëve kah ekzibicionizmi. Por ky nuk është ai i zakonshmi, që synon dallimin nga pjesa tjetër e shoqërisë. Ky synon dallimin nga brezat e mëparshëm të studentëve, duke u kthyer kësajsoj në njërin prej faktorëve që e ushqejnë efemeritetin në ligjërimin studentor. Nga përdorimi nuk dalin vetëm njësitë e trashëguara, por edhe ato të krijuara rishtaz, madje edhe *lemat flamur*. Diçka e tillë ndodh ngaqë 'arritjet' e subkulturave rinore, e bashkë me to edhe ato të ligjërimin studentor, degjenerojnë shpejt dhe ua lënë vendin të tjerave, më të reja. Fjala është për atë dukuri që disa studiues e kanë quajtur *konsumi dhe konsumizmi gjuhësor*, me të cilin lidhet ngushtë edhe *moda gjuhësore*.

Fakti që edhe vetë studentët e perceptojnë ligjërimin e tyre si një *fluks të vazhdueshëm* mjetesh komunikimi tregon se ata jo vetëm që janë të ndërgjegjshëm për efemeritetin e njësisë të entitetit të tyre, por edhe se e mbajnë atë si diçka të pashmangshme. Unë jam i mendimit se ata i lejojnë vetes të eksperimentojnë vazhdimisht, duke i përsheptuar edhe më ritmet e të ashtuquajturit *konsumizëm gjuhësor*, ngaqë edhe kur pranojnë të identifikohen me të, entiteti në fjalë nuk është i vetmi variant me të cilin mund të komunikojnë. Nëse 'punët venë keq', prapa dere presin gjithmonë dialekti, gjuha e zakonshme, madje edhe standardi.

V. Lema konstante dhe lema e dalë nga përdorimi

Janë këto fakte të vëna re edhe nga të tjerë që më çojnë në përfundimin se, sado paradoksale që të duket, te efemeriteti i njësisë të ligjërimin studentor ndikojnë po ata faktorë që shpien edhe në lindjen e tij. Dinamika e raporteve mes bartësve të tij dhe botës, e shenjuar nga një qarkullim i përsheptuar i vlerave dhe ideve, edhe falë ndihmës bujare që ofrojnë arritjet e teknologjisë së lartë, nevoja për t'u afirmuar si grup dhe si individ, revolta ndaj çdo gjëje 'të vjetër' dhe ndaj përpjekjeve për kontroll

shoqëror i bëjnë njësitë e ligjërimit të sotëm studentor edhe më efemere se simotrat e tyre. Për mendimin tim, është me interes të hetohet se si dhe sa ndikojnë në efemeritetin e elementeve të këtij entiteti marrëdhëniet që ai vendos me gjuhën e zakonshme. Është thënë shpesh, madje edhe në këtë punim⁷, se, pasi dalin nga përdorimi, ngaqë humbasin në terma të shprehësisë dhe 'shteknicizohen', disa njësi të ligjërimit studentor mund të kalojnë në gjuhën e zakonshme.

Nga ana tjetër, ka njësi që gjallojnë në të dyja variantet, e kjo nuk përbën ndonjë 'çudi'. Kam pasur rast ta vërej diçka të tillë në lidhje me njësitë *garip*, *dorë*, *gomë* etj. Unë e lidh këtë fakt me prestigjin që gëzojnë në kohë të ndryshme disa njësi të ligjërimit studentor, por nuk duhet harruar as ajo që Berruto e quan 'mbivendosja e varianteve'(Berruto). Tani çështja është të kuptohet nëse ndikon në 'konsumimin' e njërive të ligjërimit studentor kjo lloj simbioze me gjuhën e zakonshme. Në parim do të thoshim *po*, sepse prania e këtyre njërive edhe në një variant tjetër bën që ato të mos e luajnë dot ashtu siç duhet rolin identifikues për të cilin thirren ose krijohen në ligjërimin studentor. Por le t'u drejtohem provave: nga 66 studentë të anketuar në njësinë *garip* e dinin dhe e përdornin 45 prej tyre, ose 68%, e dinin, por s'e përdornin 21, ose 32%, ndërsa numri i atyre që nuk e dinin ishte zero.

Njësinë *është e dorës* e dinin dhe e përdornin 34 prej të anketuarve, ose 52% e numrit të përgjithshëm, e dinin, por s'e përdornin 24, pra 36% dhe nuk e dinin 8 ose 12%. *Bëri gomë* e dinin dhe e përdornin 6 studentë, ose 9%, e dinin, por s'e përdornin 18, pra 27% dhe nuk e dinin 42, ose 64% e të anketuarve. Këto të dhëna provojnë se *garip* dhe *është e dorës* mbeten ende *lema konstante* të ligjërimit studentor, ndërsa *bëri gomë* është në rrugën e daljes nga përdorimi. Nga ana tjetër, ato dëshmojnë se simbioza me gjuhën e zakonshme nuk i 'dëmton' njësoj të gjitha njësitë e ligjërimit studentor, madje ndonjë syresh, si fjala vjen *garip*, mund ta ndihmojë të mbahet ende aty. Mjafton t'i hedhësh një sy tabelës nr. 2, ku elementet renditen sipas frekuencës, për t'u bindur se njësitë *lahesh me*

mushama, *Pallati i Dimrit*, *gushkuq*, *tetdhjetleksh*, *tore*, *shkrepse suedeze*, *elektrik blu* etj., kanë dalë ose janë duke dalë nga përdorimi.

Një tregues tjetër i kësaj është edhe numri mjaft i vogël i studentëve që thonë se i dinë, por nuk i përdorin. Ndonjë prej tyre, si fjala vjen *tetdhjetleksh*, e ka humbur prej kohësh referentin dhe në këtë kuptim dalja nga përdorimi është më se e përligjur. Disa të tjera, edhe pse nuk e kanë humbur referentin, i kanë këputur lidhjet me të, ngaqë mbështeteshin mbi *tregues referencialë të përkohshëm*. Me këta unë kuptoj përbërësit kuptimorë të rendit të dytë që përfaqësojnë tipare jothelbësore të realieve, të lidhura zakonisht me anën e jashtme të tyre, e prandaj lehtësisht të metaforizueshme. I tillë është për shembull rasti i njësisë *gushkuq* që dikur shënonte policin, për shkak të rombeve të kuqe në jakën e uniformës, por edhe ngaqë pjesa më e madhe e atyre që mbushnin radhët e policisë deri në vitet '90 vinin nga fshati. Tani që uniforma e policisë shqiptare ka ndryshuar dhe përbërja e saj është heterogje-nizuar mjaft, askush nuk e quan më policing *gushkuq*.

Nga 66 të anketuarit vetëm 1 thotë se e di dhe e përdor njësinë në fjalë, ndërsa 7 pohojnë se e dinë, por nuk e përdorin. Megjithatë, asnjë syresh nuk jep për *gushkuq* sinonimin 'polic'. Me tregues referencialë të përkohshëm lidhet edhe një njësi tjetër më e re e ligjërimit studentor, *njesh yll thurje* me kuptimin 'i varfër'⁹.

Kjo e ka burimin te kombinimi i tastave të telefonit celular, me të cilin njëri nga rrjetet e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, AMC-ja, u mundësonte klientëve të tij thirrje pa pagesë. Tani që ky shërbim ofrohet përmes një kombinimi tjetër njësie në fjalë nuk është më një *lemë flamur* si dy-tre vjet më parë. Prej 66 të anketuarve atë e dinin dhe e përdornin vetëm 7, pra 11%, e dinin, por nuk e përdornin 28, d.m.th. 42% dhe nuk e dinin 31 studentë, ose 47%.

Përfundim

Në të vërtetë, meqë njësitë e ligjërimit studentor janë që të gjitha të prejardhura, në një formë a në një tjetër, ato e kanë më të lehtë se të tjerat ta bjerrin lidhjen me referentin, çka, sipas meje, e

lehtëson edhe daljen e tyre nga përdorimi. Megjithatë, unë jam i mendimit se jo të gjitha njësitë që karakterizohen nga një frekuencë e vogël përdorimi janë duke e lënë ligjërimin studentor. Ka syresh që sapo janë futur në të.

Bibliografia

BERRUTO, Gaetano (2004), Prima lezione di sociolinguistica, Editori Laterza, Roma-Bari.

HOLTUS, Günter (1993), Il linguaggio giovanile nella lessicografia italiana: La lingua dei giovani (nën kujdesin e Edgar Radtke-s), Tübingen-Narr.
SCWARZE, Cristoph (1994), Struttura grammaticale e uso del lessico: Come parlano gli italiani (nën kujdesin e Tullio De Mauro-s), La Nuova Italia, Firenze..